

TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK

Selia: Rr. Sami Frashëri, Pall. TID
Pranë Universitetit “Marin Barleti”
Tirana – Albania

Pasqyrat Financiare per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

(me raportin e audituesit të pavaruar ne vazhdim)

Tirane, 24 Mars 2014

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Përmbajtja

1. Opinioni i Audituesit të Pavarur
2. Bilanci Kontabël
3. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
4. Pasqyra e flukseve monetare
5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital
6. Shënime

Raporti i Audituesit te Pavarur

Ortakut të Shoqërisë

“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK

Rr. Sami Frashëri, Pall. TID

Pranë Universitetit “Marin Barleti”

Tirana – Albania

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur te Shoqërisë “ TID” sh.p.k., te cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar te datës 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrën e ardhurave dhe shpenzimeve gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e përfunduar në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin, gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.



Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, për pozicionin financiar të Shoqërisë “TID” sh.p.k., me datën 31 Dhjetor 2013 performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Firma : Leze ABAZI

Eksperti Kontabël i Regjistruar



Datë : 26 Mars 2014

Adresa: Lagje Nr.4
Sarande-Albania

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Bilanci Kontabël

		Më datën 31.12.2013	
<u>AKTIVET</u>	<u>Shenime</u>	<u>31.12.2013</u>	<u>31.12.2012</u>
AKTIVET AFATSHKURTRA			
Aktivët monetarë	4.1;4.2	9,879,457	16,124,534
Totali		9,879,457	16,124,534
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari/Kerkesa të arktueshme	5.a)	456,984,155	539,193,230
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5.b)	18,287,254	26,637,488
Instrumenta të tjera borxhi	5.c)	27,674,983	13,831,294
Totali		502,946,392	579,662,011
Inventari			
	6		
Lendet e Para		17,676,738	39,932,546
Mallra		7,604,863	8,460,483
Inventari i imet		6,111,845	7,848,197
Totali		31,393,446	56,241,226
Parapagime dhe shpenzimet e shtyra	7	99,374,870	94,443,069
TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA		643,594,165	746,470,840
AKTIVET AFATGJATA			
	8		
Investimet financiare afatgjata			
Pjesmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	8.a)	5,000	5000
Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatgjata	8.b)	1,497,502,538	1,805,718,404
Totali		1,497,507,538	1,805,723,404
Aktive afatgjata materiale			
	9		
Ndertesa		466,692,069	490,553,689
Makineri e pajisje		114,636,269	109,682,010
Mjete inventari, transport, informatike		25,195,455	31,677,859
Totali		606,523,793	631,913,558
TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA		2,104,031,331	2,437,636,962
TOTALI I AKTIVEVE		2,747,625,496	3,184,107,802
DETYRIMET AFATSHKURTRA			
	10.1		
Huate dhe Parapagimet			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	10.1/a)	376,243,423	568,345,360
Te pagueshme ndaj punonjesve	10.1/b)	4,031,100	2,972,401
Detyrimet tatimore	10.1/c)	1,561,317	1,551,776
Totali		381,835,840	572,869,537
TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA			572,869,537
DETYRIMET AFATGJATA			
	10.2		
Huate afatgjata			
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare	10.2/a)	1,121,738,054	1,349,490,056
Totali		1,121,738,054	1,349,490,056
Huamarrje të tjera afatgjata	10.2/b)		0
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA		1,121,738,054	1,349,490,056
TOTALI I DETYRIMEVE		1,503,573,894	1,922,359,593
KAPITALI			
	11		
Kapitali aksioner, themeltar		650,733,999	650,733,999
Rezervat ligjore			
Fitimet e pashperndara		566,014,210	551,202,737
Fitimet (humbja) e vitit financiar		27,303,393	59,811,473
TOTALI KAPITALIT		1,244,051,602	1,261,748,209
TOTALI E DETYRIMEVE KAPITALIT		2,747,625,496	3,184,107,802

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-15

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e të Ardhurave

		Për periudhën që përfundon më 31.12.2013	
		31.12.2013	31.12.2012
SHITJE NETO	Shenime	589,060,894	728,525,456
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		19,288,741	10,329,420
Totali I te ardhurave	12.1	608,349,635	738,854,876
Mallrat, lendet e para dhe shërbimet	12.2	(345,369,708)	(418,863,902)
Shpenzimet te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	12.3	(45,428,106)	(40,956,850)
Shpenzimet e personelit			
<i>Pagat</i>	12.4	(58,848,903)	(49,950,720)
<i>Shperblime</i>		(770,082)	
<i>Shpenzimet e sigurimeve shoqerore</i>		(8,773,464)	(7,865,910)
Shpenzime t tjera rrjedhese	12.5	(12,254,799)	(2,436,548)
Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi	12.6	(46,316,325)	(50,750,827)
Totali I shpenzimeve		(517,761,387)	(570,824,757)
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		90,588,248	168,030,119
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesmarrjet	12.7		
Te ardhurat dhe shpenzimet financiare			
<i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>	12.8	(53,949,998)	(97,594,742)
<i>Fitime (humbje) nga kursi I kembimit</i>	12.9	(3,742,006)	(1,739,687)
<i>Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare</i>	12.10		
Totali I te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		(57,692,004)	(99,334,429)
Fitimi (humbja) para tatimit		32,896,244	68,695,690
Shpenzimet e tatim fitimit		(5,592,851)	(8,884,217)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		27,303,393	59,811,473

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-15

TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA - ALBANIA

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e flukseve monetare- Metoda direkte

Për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

	Viti 2013	Viti 2012
Fluksi nga aktiviteti operativ	284,418,038	433,636,852
Fitimi neto pas tatimit	27,303,393	59,811,473
Ndryshimi i klientave	82,209,074	405,891,225
Furnitore --debitore	2,897	
Shteti tvsh	11,381,634	(3,286,222)
Furnitoret	(192,101,937)	(200,937,660)
Hua te dhena afatshkurtra	(13,843,689)	(13,831,294)
Situacione te pashitura	308,362,626	107,658,892
Te tjera kerkesa (tatim fitimi)	(3,034,297)	(1,132,199)
Huara te dhena afatgjata	(146,760)	83,191,634
Sigurime shendetsore dhe shoqerore		
Pagat	1,058,699	1,944,554
Detyrime shteti tatim taksa, tvsh,TAP,etj	9,541	(15,589,710)
Hua te marra afatgjata		0
Parapagime dhe pagesa pjesore	(4,931,801)	(2,046,666)
Ndyshimi i inventarit	24,847,780	(38,788,002)
Amortizimi	43,300,878	50,750,827
Kuota pjese e shpenzimeve per t'u shperndarë		
Fluksi i parave nga aktiviteti investues	(62,911,313)	(12,333,723)
Ndryshimi i Kapitali themeltar		
Blerje dhe rivleresime AQT të tjera	(26,540,524)	(12,929,959)
Pakesim AQT nepermmjet shitjes	8,629,211	596,236
Pakesim kuota pjesmarrje		
Shperndarje dividendi	(45,000,000)	
Pakesimi fitimi i pashperndare,(gjoba akt, kontrolli)		
Fluksi i parave nga aktiviteti Financues	(227,752,002)	(428,477,003)
Huara te tjera		(182,057,230)
Hua bankare	(227,752,002)	(246,419,773)
Fluksi neto i parave	(6,245,277)	(7,173,874)
	Likuiditetet	Likuiditetet
Teprica ne fillim	16,124,534	23,298,408
teprica ne fund	9,879,257	16,124,534
Diferenca	(6,245,277)	(7,173,874)

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-15

TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA ALBANIA

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Pasqyra e ndryshimit të kapitaleve të veta për periudhën që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

000/lek

	Kapitali Themeltar	Rezerva statusore dhe ligjore	Rezerva te tjera	fitimi I pashperndare	Fitimi I periudhes	totali
pozicioni me 31.12.2012	650,734	-	-	288,808	262,394	1,201,936
Kalimi i fitimit 2010 ne fitimit te akumuluar				262,394	(262,394)	-
Fitimi neto I vitit financiar					59,811	59,811
Pakesim fitime te pashpernadra						-
Shpendarje dividenti						-
pozicioni me 31.12.2013	650,734	-	-	551,202	59,811	1,261,747
Kalimi i fitimit 2012 ne fitimit te akumuluar				59,811	(59,811)	0
Fitimi neto I vitit financiar					27,303	27,303
Pakesim fitime te pashpernadra						
Shpendarje dividenti				(45,000)		(45,000)
pozicioni me 31.12.2013	650,734			566,013	27,303	1,244,050

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-15

Pasqyrat Financiare “Tirana International Development” Shpk janë aprovuar nga Drejtimi i Degës
Më datë 24 Mars 2014

Behar Male

Administrator i vetëm

TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA ALBANIA

Flutura Kulla

Shefe e Financës

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria TID sh.p.k., në vijim e quajtur Shoqëria, është themeluar me vendimin e Gjykatës Tiranë nr.20374, në vitin 1998 në datën 3 të muajit Dhjetor, nga ortaku i vetëm, i cili ishte edhe administrator i shoqërisë, z. Behar Male. Gjatë viteve kapitali i shoqërisë ka ndryshuar dhe këto ndryshime janë formalizuar me vendimet përkatëse të gjykatës së Tiranës.

Në datën 31 Dhjetor 2013 përberja dhe zotërimi i kapitalit të shoqërisë TID sh.p.k. është 650,734,000 lekë dhe paraqitet si vijon:

Emeri i ortakut	Vlera e kapitalit	Numri i pjeseve	% e kapitalit
BEHAR MALE	650,734,000	100	100%
Totali	650,734,000	100	100%

Ortak i vetëm dhe Administrator i shoqërisë është Behar Male.

Objekti kryesor i shoqërisë është Import-eksport, rieksporim, tranzitim, tregetim të gjitha mallrave të ndryshëm me shumice e pakice, produkte me origjin buqësor, blektorale, mallra të ndryshëm ushqimor të gatshëm e gjysem të gatshëm, materiale ndertimi të llojeve të ndryshme, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare. Marrje persiper e hartimit të projekteve të ndryshme ndertimore të fushave të ndryshme dhe të realizimit të anes ndertimore të tyre. Investime në fushën e turizmit, infrastrukture, konvertim të valutave, qiradhenes se zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme Veprimtari në fushën e estetikës dhe dermokozmetikës, hapja dhe mbajtja e qendrave me profil estetikën, dermo-kozmetikën, trajtimin e lekures dhe trupit, masazheri dhe mirembajtje trupore, fitness dhe pishina. Gjate vitit 2013 shoqëria ka vazhduar me aktivitetin në ndertim, qiradhenie.


Adresa e Shoqërisë është : Rruga "Sami Frasheri" Pallati "TID" pranë Universitetit "Marin Barleti" shkalla e dyte , kati i dyte.

Shoqëria është e rregjistruar si person juridik në Degen e Tatimpaguesve të Medhenj me NIPT J82427007R.

Me 31 Dhjetor 2013 shoqëria ka 121 punonjes (31 Dhjetor 2012, 104 punonjes)

Sipas ligjit Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" datë 29.04.2004 parashikohet zbatimi në Shqipëri i dy paketave të rregullimit kontabël (a) Standardet Kombëtare të kontabilitetit si dhe (b) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të njohura si SNRF) për të gjitha shoqëritë tregtare. Sipas këtij ligji Standardet Kontabël që do të zbatohen nga shoqëritë paraqiten si më poshtë:

- (i) Bankat dhe Institucionet Financiare- të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (ii) Shoqëritë e Mëdha me qarkullim vjetor mbi 1.25 miliard lekë dhe mbi 100 punonjës - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iii) Degët e shoqërive të huaja - të gjithë paketën e SNRF dhe KNISRF përkatëse
- (iv) Shoqëritë e Vogla dhe të Mesme – Standardet Kombëtare Kontabël



2. Parimet e përgatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabël

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK) të publikuara bazuar ne urdhrin e Ministrit të Financave nr 4942 datë 15.06.2016 “Për Shpalljen e Standardeve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

(b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit te koston historike.

Politikat kontabël për shifrat e vitit 2013 janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe paraqiten në shënimin vijues.

3. Politikat kontabel kryesore

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

3.1 Aktivet Afatgjata

AAGj janë njohur në momentin kur shoqëria është bërë titullare ligjore e tyre ose ka kontrollin ekonomik mbi to, pret të marrë përfitimet në të ardhmen dhe kur mund të vlerësohen në mënyrë të bësueshme. Në njohjen fillestare aktivet vlerësohen me koston e sigurimit të tyre e cila përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve .

Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbatjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Në bilanc paraqiten të vlerësuar me koston e amortizuar e cila rezulton si diferencë nga kostoja e tyre minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi i AAM të hyra gjatë vitit llogaritet në raport me kohën e hyrjes së tyre. Në rast rivlerësimi aktivet vlerësohen me koston e caktuar në raportin e ekspertit të vlerësimit. Amortizimi i AAM llogaritet në përputhje me normat e caktuara nga ligji nr. 8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat”. Amortizimi i ndërtesave llogaritet me metodën lienare kurse amortizimi i grupeve të tjera llogaritet me metodën e vlerës së mbetur, duke marrë për afërsisht jetëgjatësinë e këtyre aktiveve. Metodatat dhe normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria paraqiten si me poshte:

	Norma Amortizimit %	Metoda Llogaritjes
Ndërtesa	5%	me Vleften e mbetur
Makineri e pajisje	20	me Vleften e mbetur
Mjete Transporti	20	me Vleften e mbetur
Mobilje Orendi	20	me Vleften e mbetur
Pajisje Informatike	25	me Vleften e mbetur

3.2. Aktivet dhe detyrimet financiare

a) Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesa të tjera. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

Llogari e kërkesave të Arkëtueshme

Kërkesat e arkëtueshme ndaj klientave njihen si aktive atëherë kur Shoqëria bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për t'u arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i Shoqërisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

Shuma e zhvlerësimit nga borxhi i keq është diferenca midis vlerës së mbartur të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të parashikuar të ardhshme të parave, të skontuar me normën origjinale efektive të interesit. Vlera e mbartur e aktivit zvogëlohet duke përdorur një llogari Zhvlerësime, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur një Llogari e Arkëtueshme nuk mund të arkëtohet, ajo nuk paraqitet në shpenzime por çrregjistrohet nga Llogaria e Zhvlerësimit të borxhit të keq dhe nga Llogaria e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë ç'regjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma.

Një aktiv financiar ç'regjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Shoqëria parashikon që nuk do gjenerohen më flukse monetare nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin.

Shoqëria paraqet në aktivet e saj të gjitha shpenzimet e parapaguara dhe të cilat pret që t'i shpërndajë në periudhat e ardhme, ose të drejtat për të ardhurat e llogaritura në avancë.

b) Detyrimet financiare

Shoqëria i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: Llogari të pagueshme dhe detyrime tregtare të tjera dhe detyrime financiare.

Detyrime tregtare dhe të tjera paraqesin Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit janë paraqitur me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

b) Detyrimet financiare - vazhdim

Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual që ka lindur nga një ngjarje e shkuar, shlyerja e të cilit pritet të shoqerohet me dalje të burimeve dhe mund të behet një vlerësim relativisht i sakte i shumës së detyrimit.

3.3 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë MM në dore dhe ato të mbajtura në banka.

Në përputhje me SKK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshijnë MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak). Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshijnë investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollat e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

3.4 Njohja e të ardhurave


Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimit e pronësisë së produktit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri. Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen kur janë kryer shërbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo. Të ardhurat nga ndërtimi njihen në masën e kryerjes së punimeve mujore të kryera dhe situacionuara. Të ardhura nga bari dhe restoranti regjistrohen kur arkëtohen mjete monetare ose kur realizohet shitja.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Shpenzime për personelin

(i) Kontributet për sigurime shoqerore dhe të ngjashme

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj normal, kryen pagesa në emer të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet për sigurimet shoqerore dhe shëndetësore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kostot perkatese të bera në emer të Shoqërisë ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave me ndodhjen e tyre.



Shpenzime per personelin - Vazhdim

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqëria njih si një shpenzim personeli ato kosto që lidhen me lejen e zakonshme atëherë kur është përdorur nga personeli perkates.

3.5 Transaksionet me monedhat e huaja

Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon shoqëria ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

(b) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "të tjera të ardhura (shpenzime) financiare".

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2013 janë:

Data /	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Monedha		
Euro	140.2	139.59
USD	101.86	150.45


3.6 Rezultati tatimor

Shoqëria llogarit vetëm tatimin aktual. Ajo nuk ka zgjedhur përdorimin e tatimit të shtyrë mbi fitimin. Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël. Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohura. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon t'i paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

4. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mjeteve monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e parave në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë.

Konvertimi i gjendjes në valutë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2013 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultat. Shoqëria nuk ka ekuivalente të mjeteve monetare



PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET

4.1. Mjetet monetare në llogaritë bankare

Gjendja e llogarive bankare në fund të periudhës në kontabilitet përputhet me gjendjen sipas nxjerrjes së llogarive bankare. Përbërja analitike e llogarive bankare paraqitet si vijon:

	Viti 2013	Viti 2012
	Në lekë	Në lekë
Depozita ne banke dhe ne llogari te tjera		
Banka ne leke	2,031,516	642,867
Banka ne valute (te shpehura ne lek)	2,221,624	4,409,471
Totali	4,253,140	5,052,338

4.2 Mjetet monetare në arkë

Gjendja në arkë në vitin 2013 përbëhet nga gjendjet e parave në monedhën kombëtare lek ,dhe në euro në fund të periudhës.

	Viti 2013	Viti 2012
	Ne leke	Në lekë
Para ne dore (arke)		
Cash ne lek	336,357	9,600,223
Cash ne euro te konvertuar ne lek	5,289,760	1,459,553
Cash ne USD te konvertuar ne lek		12,421
Totali	5,626,117	11,072,198

5.Aktivitet te tjera financiare afatshkurtra

Në postin e bilancit "Aktive te tjera financiare afatshkurtra" me date 31 Dhjetor 2013, paraqiten ne bilanc kërkesat ndaj të tretëve me vleren e tyre te arketueshme. Ato përbëhen tërësisht nga të drejtat ndaj klientave,furnitore, debitore, shteti tatim taksa, instrumenta te tjera borxhi. Përbërja analitike e këtyre të drejtave paraqitet si vijon:

5.a Llogari / kërkesa te arketueshme

Paraqitja e llogarive të arkëtueshme jepet në tabelën vijuese:

Nr.	Kliente	Viti 2013	Viti 2012
1	Kliente investitore privat	50,431,456	50,431,456
2	Institucione buxhetore	34,935,558	41,870,184
3	Kliente objekte ne ndertim		
4	Kliente te tjere	371,617,141	326,891,590
5.	Kliente per fitim, min, fisk. Pjesa e pashitur		120,000,000
	TOTALI	456,984,155	539,193,230

5.b Kërkesa te tjera te arketueshme

Paraqitja e kërkesa te tjera të arkëtueshme jepet në tabelën vijuese:

Furnitore Debitore	Viti 2013	Viti 2012
Parapagime dhe pagesa pjesore	8,561,403	8,564,300

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT “SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Shteti “Tatim Taksa”	9,725,851	18,073,188
Totali	18,287,254	26,637,488

Në grupin e ”Shteti tatime e taksa” paraqiten elementët vijues:

Shteti tatim dhe taksa	Viti 2013	Viti 2012
Tvsh e paguar ne dogane	132,571	132,130
TVSH	5,426,784	16,808,859
Tatim fitimi	4,166,496	1,132,199
Totali	9,725,851	18,073,188

5.c Instrumenta te tjera borxhi

Paraqitja e Instrumentave te tjera borxhi jepet ne tabelen e meposhtme:

	Viti2013	Viti 2012
Hua Kruja S	1,871,154	1,871,154
Banka Popullore ne sponsorizim	3,526,599	3,511,255
Tuna Konstruksion		8,448,885
Hua Soal	32,947,000	
Debitore te ndryshem	(10,669,770)	
Totali	27,674,983	13,831,294

6. Inventaret

Gjendja e inventarëve materialeve te para analitikisht paraqiten si ne tabelen vijuese:

Emertimi	Viti 2013	Viti 2012
Materiale dhe Lende te para	17,676,738	39,932,546
Te tjera gjendje inventari	6,111,845	7,848,197
Mallra	7,604,863	8,460,483
Totali	31,393,446	56,241,226

7. Parapagimet dhe Shpenzimet e shtyra

Një paraqitje analitike e këtyre shpenzimeve jepet ne tabelen me poshte:

Shpenzime,kosto per tu shperndare	Viti 2013	Viti 2012
Kosto për tu shpërndarë-Projekti Drini & takse ndertimi	97,936,816	93,005,016
Pishina & SPa	1,438,054	1,438,054
Totali	99,374,870	94,443,069

Në zërin Kosto për tu shpërndarë – Projekti Drini dhe Taksa ndërtimi, përfshihen shpenzimet projekte dhe takes ndertimi per objektin qe eshte ne process ndertimi, ne rrugen “28 Nentori”. Në zërin Pishina & SPA, përfshihen shpenzimet e trajnimit te personelit te qendres Nobis Wellnes

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Center e cila ka filluar funksionimin ne muajin janar 2012, dhe keto shpenzime do te shperndahen ne vitin ne vazhdim

8. Aktivet financiare afatgjata

Në këtë grup përfshihen disa nëngrupe të A.financiare afatgjata.

8.a) Investime në pjesmarrje

Paraqet një pjesmarrje në kapital në shoqërinë "Hydroborsh" shpk ne masen 5% me vlere 5,000 lek
Informacioni paraqitet si vijon:

	Viti 2013 Në lekë	Viti 2012 Në lekë
Pjesmarrje te tjera në njësi të kontrolluara		
Pjesmarrje ne shoqerine Hydroborsh shpk	5,000	5,000
Totali	5,000	5,000

8.b) Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatgjata

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

	Viti 2013 Në lekë	Viti 2012 Në lekë
Kërkesa të tjera të arkëtueshme afatgjata		
Llog/kerkesa te ark. Afatgjata, (Situacione)	1,463,771,819	1,772,134,446
Llog/ Kerkesa (hua) te arkëtueshme afatgjata(Hua)	33,730,718	33,583,958
Totali 1	1,497,502,538	1,805,718,404

Në zërin Llog/kerkesa te ark. Afatgjata, (Situacione) paraqiten shumet e situacioneve të punimeve të kryera për disa objekte që janë në procesin e shitjes apo ndërtimit, si psh në objekti Golem, Don Bosko, Laboratori, Drini, etj.

Përbërja e zërit Kërkesa (Hua) të arkëtueshme afatgjata paraqitet si vijon:

	Viti 2013	Viti 2012
Kërkesa (Hua) të arkëtueshme afatgjata		
Kredi te dhena te treteve	33,730,718	33,583,958
Totali	33,730,718	33,583,958

9. Aktivet Afatgjata

Gjatë vitit 2013 shtesat e AAM janë paraqitur me koston e tyre.

Në vijim paraqitet një pasqyrë në lidhje me lëvizjet e Aktiveve Afatgjata dhe Amortizimit të tyre gjatë vitit 2013:

Pasqyra e Ndryshimeve te Aktiveve Afatgjata				
Emertimi I Aktivit	Gj. me 01.01.2013	Shtesat gjate vitit	Daljet gjate vitit	Gj. me 31.12.2013
Ndertesa	649,781,587			649,781,587
Instalime, makineri e pajisje	175,104,341	19,941,518	695,240	194,350,619

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Mjete transporti	7,836,296			7,836,296
Pajisje zyre e informatike	42,926,067	6,599,006	7,933,971	41,591,102
Totali	875,648,291	26,540,524	8,629,211	893,559,604

Pasqyra e Ndryshimit te Amortizimit te Aktiveve Afatgjata Materiale

Emertimi I Aktivit	Gj. me 01.01.2013	Amortizimi Vjetor	Pakesime nga dalje AQT	Gj. me 31.12.2013
Ndertesa	159,227,898	23,861,420		183,089,318
Instalime, makineri e pajisje	65,422,331	14,987,259	695240	79,714,350
Mjete transporti	6,086,732	349,914		6,436,646
Pajisje zyre e informatike	12,997,772	7,117,732	2,320,207	17,795,297
Totali	243,734,733	46,316,325	3,015,447	287,035,611

Teprica me Vleften e mbetur te Aktiveve Afatgjata Materiale

Emertimi I Aktivit	Gj. me 01.01.2013	Shtesat gjate vitit	Daljet gjate vitit	Gj. me 31.12.2013
Shpenzimet e nisjes				
Ndertesa	490,553,689		23,861,420	466,692,269
Instalime, makineri e pajisje	109,682,010	19,941,518	14,987,259	114,636,269
Mjete transporti	1,749,564	-	349,914	1,399,650
Pajisje zyre e informatike	29,928,295	6,599,006	12,731,496	23,795,805
Totali	631,913,558	26,540,524	51,930,089	606,523,993

Shtesat e aktiveve në vitin 2013 kanë ardhur nga blerjet, te cilat janë njohur me koston e blerjes, ndërsa pakesimet kane ardhur nga shitja pajisjeve , nga amortizimi i plote i disa pajisjeve te ineqntarit, si dhe amortizimet vjetore.

10. Detyrimet

Detyrimet perbehen nga detyrimet afatshkurtera dhe ato afatgjata. Sipas kontabilitetit te klasifikuara ne kete kriter ato paraqiten:

10.1 Detyrimet afatshkurtera

Paraqitja e tyre ne bilancin kontabel jepet si ne tabelen qe vijon:

Detyrime afatshkurtera	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Furnitorë për blerje e shërbime	376,243,423	568,345,360
Personeli	4,031,100	2,972,401
Sigurime shoqërore e të ngjashme	1,561,317	1,199,868
Detyrime Tatimore		351,908

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Totali	381,835,840	572,869,537
---------------	--------------------	--------------------

10.1/a) Detyrimet ndaj Furnitoreve

Detyrimet ndaj furnitoreve jane paraqitur ne bilanc per shumat qe do te paguhen pas dates 31.12.2013. Një paraqitje analitike e tyre jepet ne tabelen më poshte:

Furnitorë në Euro	756,241 lek
Furnitorë në Lekë	365,087,062 lek
Furnitorë në USD	10,400,120 lek
Totale	376,243,423

10.1/b) Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqet detyrimin e shoqerise ndaj punonjesve per pagen e muajin dhjetor e cila eshte paguar ne muajin janar 2014.

10.1/c Detyrimet Tatimore

Detyrimet ndaj shtetit per tatime e taksa paraqiten ne seksionin e detyrimeve afatshkurtëra ne Pasqyrat financiare. Perbërja analitike e këtyre detyrimeve ndaj shtetit paraqitet si vijon:

	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Shteti tatime e taksa		
TVSH e pagueshme		
Tatim mbi te ardhurat personale	309,267	378,893
Sigurimet shoqerore	1,252,050	1,199,868
Detyrimi Tatim fitimi i vitit		0
Tatim ne burim		(26,985)
Tatime nga gjoba aktkontrolli		0
Totali	1,561,317	1,551,776

Sigurime shoqerore e te ngjashme paraqesin shumën e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore te llogaritura mbi pagat e punonjesve per muajin dhjetor. Keto detyrime jane paguar ne muajin janar 2014.

Tatimi mbi të ardhurat e punonjësve paraqet shumën e këtyre tatimeve të llogaritura në muajin dhjetor 2013.

10.2 Detyrimet afatgjata

Përbërja e detyrimeve afatgjata paraqitet si vijon:

	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Huate afatgjata		
Hua, bono dhe detyrime nga qiraja afatgjate	1,121,738,054	1,349,490,056
Huamarrje te tjera afatgjata		0
TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA	1,121,738,054	1,349,490,056

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

10.2/a) Hua, bono dhe detyrime nga qiraja afatgjate përbëhen nga huat bankare afatgjata. Një paraqitje e tyre jepet në tableën vijuese:

Kredite bankare afatgjata	Viti 2013	Viti 2012
	Ne leke	Ne leke
FIB	153,762,892	170,500,338
Tirana bank	0	311,611,412
Banka Popullore	123,528,040	170,297,952
Alfa Bank	375,916,808	439,373,601
BKT	468,530,314	257,706,753
Totali	1,121,738,054	1,349,490,056

10.2/b) Huamarrje te tjera afatgjata

Gjate vitit 2013 shoqeria nuk ka detyrime per huamarrje te tjera afatgjata.

11 Kapitalet e veta

Përbërja dhe ndryshimi i kapitaleve të veta per vitin 2013 jepet në pasqyrën vijuese:

Kapitali Aksionar qe I perket aksionereve te shoqerise Me date 31.12.2013						000/leke
	Kapitali Themeltar	Rezerva statusore dhe ligjore	Rezerva te tjera	fitimi I pashperndare	Fitimi I periudhes	totali
pozicioni me 31.12.2008	650,734			204,018		854,752
Fitimi neto I vitit financiar					83,802	83,802
Pakesim fitime te pahpernadra				(867)		(867)
Rimarrje provizioni						
pozicioni me 31.12.2009	650,734	-	-	203,151	83,802	937,687
Pozicioni me 31.12.2009	650,734			286,953		937,687
Fitimi neto I vitit financiar					31,855	31,855
Pakesim fitime te pahpernadra						-
Shpendarje dividenti				(30,000)		(30,000)
pozicioni me 31.12.2010	650,734	-	-	256,953	31,855	939,542
Kalimi i fitimit 2010 ne fitimit te akumuluar				31,855	(31,855)	-
Fitimi neto I vitit financiar					262,394	262,394
Pakesim fitime te pahpernadra						-
Shpendarje dividenti						-
pozicioni me 31.12.2011	650,734	-	-	288,808	262,394	1,201,936

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Kalimi i fitimit 2011 ne fitimit te akumuluar				262394	-262394	0
Fitimi neto I vitit financiar					59811	59811
Pakesim fitime te pashpernadra						
Shpendarje dividenti						
pozicioni me 31.12.2012	650,734			551,202	59,811	1,261,747
Kalimi i fitimit 2012 ne fitimit te akumuluar				59,811	(59,811)	-
Fitimi neto I vitit financiar					27,303	27,303
Pakesim fitime te pashpernadra						
Shpendarje dividenti				(45,000)		(45,000)
pozicioni me 31.12.2013	650,734			566,013	27,303	1,244,050

12. Të ardhurat dhe shpenzimet

Për periudhën kontabël që mbyllet më 31 dhjetor 2013 shoqëria "TID" shpk ka kryer shpenzime dhe ka realizuar të ardhura të cilat janë paraqitur përkatësisht në klasat 6 dhe 7.

12.1 Shitjet neto

Gjatë vitit 2013 shoqëria ka realizuar të ardhura nga shitjet e situacioneve, shërbimeve, qirave, shitja e produkteve (apartamente, garazhe, dyqane, etj), shërbime qendra Nobis, etj Përbërja e shitjeve neto paraqitet si në tabelën vijuese:

Të ardhurat neto	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Nga kryerja e shërbimeve, Situacionet	299,859,041	165,088,368
Nga shitja e produkteve te prodhimit vet	200,656,465	505,832,302
Te tjera	19,288,741	10,329,420
Nga qirate	88,545,388	57,604,786
TOTALI	608,349,635	738,854,876

Në grupin e të ardhurave nga kryerja e shërbimeve jane paraqitur situacionet e punimeve te kryera per vitin 2013 .

Ne te ardhurat nga shitja e produkteve te prodhimit te vet praqiten si me poshte:

12.1 Shitjet neto - Vazhdim

Te ardhura nga shitja e produkteve te veta	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Sherbime klinika vivia	0	6,911,279
Te ardhura nga sipërf. e shitura , labor.	82,310,940	447,150,143
Te ardhura nge qendra Nobis	99,129,740	51,770,880
Te ardhura nga hoteleria	19,215,785	0

PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Sherbime klinika vivia	0	6,911,279
Te ardhura nga siperf. e shitura , labor.	82,310,940	447,150,143
Te ardhura nge qendra Nobis	99,129,740	51,770,880
Te ardhura nga hoteleria	19,215,785	0
Totali	200,656,465	505,832,302

Ne te ardhurat nga sip. e shitura prej 82310 mije lek perfshihet vlera e kontratave te shitjes se siperfaqeve ne godinen ne rr. S Frasheri per te cilat shoqeria ka hartuar kontrata porosie dhe shitje perfundimtare dhe ka arketuar pjeserish shuma monetare.

Ne te ardhurat nga qirate, jane perfshire te ardhurat e realizuara nga dhenia me qira e ambienteve ne Qendren e Biznesit "Twin Tower" ne bulevardin "Deshmoret e Kombit", dhe te ambienteve te tjera. Per keto te ardhura shoqeria ka prere fatura tatimore shitje ku tvsh nuk eshte e llogaritur pasi qirate jane me afat mbi 2 muaj.

Te tjera Shitje e Sherbime

Te ardhura nga "Te tjera shitje e sherbime" ne menyre analitike pasqyrohet si me poshte:

	Viti 2013	
	Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Te ardhura nga te tjera shitje e sherbime		
Te ardhurat nga shperndarje e faturave Telefonit	177,177	2,633,960
Te ardhurat nga shperndarja e faturave të Energjise, ujit dhe karburantit	1,812,804	1,424,260
Te ardhura nga shitja e AAM	5,615,562	6,271,200
Te ardhurat nga autofaturat	11,683,198	
Totali	19,288,741	10,329,420

Te ardhurat nga shitja e AAM perfaqeson shitjen e disa pajisjeve te inventarit te vleresuara me vleren e mbetur. Te ardhurat nga autofaturat perfaqesojne autofaturimin e sherbimeve te manaxhimit te aktivitetit tregtar te qendres Nobis nga nje firme e huaj italiane .

12.2 Mallrat, Lendet e para dhe sherbimet

Në këtë post janë përfshirë kostoja e blerjes së materialeve të para, mallrave dhe mat. ndihmëse për aktivitetin e ndertimit dhe te tregëtise dhe sherbimet ne funksion te aktivitetit kryesor te shoqerise si shpenzime per punimet nga nenkontraktoret, shpenzime per energji elek. ,transport,etj Analitikisht përbërja e këtij zëri të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet si vijon:

Mallrat , Lendet e para dhe sherbimet	Viti 2013	
	Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Lendet e Para	73,105,390	68,263,140
Mallra	18,180,299	10,991,355
Armature , perpunim hekuri, murature,	213,549,248	80,752,971
Shpenz. Energji + uje	24,712,609	26,154,419
Qira + mirembajtje dhe riparime	13,007,341	6,012,565
Studime kerkime, projekte dhe analiza laboratorike		0
Transport materialesh	2,814,822	1,491,427
Kosto e mallrave te shitura (ndertesa rr.S.Frasheri)		225,198,023
Totali	345,369,708	418,863,900

12.2 Mallrat, Lendet e para dhe sherbimet - Vazhdim

Ne zerin armature perpunim hekuri, murature, etj. perfshihen sherbimet nga te trete per procesin e ndertimit.

Ne zerin Qera dhe mirembajtje perfshihen shpenzimet per kuoten e administrimit te ambienteve te dhena me qira ne Qendren e Biznesit dhe administrimi ne ambientet e tjera ku zhvillohet aktiviteti tregtar.

12.3 Shpenzimet te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Shpenzimet te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Primet e sigurimit	582,071	918,413
Te ndryshme, noterizime + kanceleri , roje private	4,224,014	2,793,651
Pagesa te ndermjetme dhe honorare , anetaresim	12,309,195	15,303,173
Reklama , publicitet	1,741,959	4,160,294
Shpenzime telefoni . vodafon dhe tel. Fiks	4,155,394	4,963,360
Tatime , taksa bashkie e automjete. taks. m2	8,349,656	9,455,322
Shpenzime per mirembajtje dhe riparime		0
Shpenzime udhetimi dhe dieta	189,270	163,800
Kerkime dhe studime	5,000	131,350
Shpenzime per sherbime bankare	2,188,349	3,067,487
Shpenzime per autofatura	11,683,198	
Totali	45,428,106	40,956,850

12.4 Shpenzime personeli

Gjate vitit shoqeria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar ne përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punojnësit. Fondi i pagave sipas kontabilitetit është 58,848,903 lek, ndersa totali i pagave mbi te cilen llogariten kontributet është 52,471,620. Diferenca prej 6,377,283 lek pasqyron diferencen e pagave mbi nivelin e pages maksimale mbi te cilen llogariten sigurimet shoqerore.


Gjithashtu ka nje mosperputhje te fondit te pagave sipas kontabilitetit me pagen per efekt te llogaritjes se tatim mbi te ardhurat personale. Fondi i pagave per efekte TAP është 40,577,331 lek Diferenca prej 18,259,672 lek me fondin e pagave gjithsej rezulton nga diferenca e pagave te punonjesve deri ne 30,000 lek tper te cilet nuk mbahet TAP.

Shpenzime per kontributin e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore është 8,773,464 lek , ndersa ne zerin shpenzime te tjera per personelin perfshihen shperblimet e punonjesve ne natyre ne masen prej 770,082 lek.

12.5 Shpenzime të tjera rrjedhese

Ne postin "Shpenzime te tjera rrjedhese " jane perfshire shpenzimet qe pasqyrohen si ne tabelen e meposhtme:

Shpenzime të tjera rrjedhese	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Shpenzime per pritje e perfaqesime	4,050	
Sponsorizime	5,611,727	1,500,000



PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE
"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT "SHPK
Për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2013

SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHJE SHKRUHET

Gjoha dhe penalitete	1,025,258	340,316
Vlera kontabel e AQT te shitura	5,613,764	596,236
Total	12,254,799	2,436,552

Ne zerin shpenzime per sponsorizime perfshihen sponsorizimin per rikonstruksionin e godines se Universitetit Bujqesor Kames. Ky shpenzim konsiderohet si shpenzim i zbritshme fiskal per arsye se ploteson kushtin e kufirit te lejuar te shpenzimeve sipas dispozitave ligjore ne fuqi . Në zërin e Gjoha dhe kamat vonesa perfshihen gjobat e lena nga akti i kontrollit si dhe gjoba te shlyerjeve me vonese te kesteve te kredive.

12.6 Zhvleresime dhe amortizime

Ne menyre analitike ky ze zberthehet:

SHpenzime amortizimi dhe zhvlerësime	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Shpenzime amortizimi	46,316,325	50,750,827
Total	46,316,325	50,750,827

Ne zerin e amortizimeve perfshihen shpenzimet e amortizimit te ndertesave, makineri e pajisje, mjete transporti dhe inventar. Per efekt te llogaritjes se tatim fitimit fiskal eshte bere zbritja e shpenzimeve te amortizimit per pjesen e rivleresuar te ndertesave ne masen prej 18,318 mije lek. Ndersa shpenzimet per amortizimin e aktiveve te tjera afatgjata jane llogaritur me normat e amortizimit ne mbeshtetje te ligjit 8438 date 28.12.1998 per "Tatimin mbi te ardhurat" mbi vleren e mbetur.

12.8 Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	Viti 2013 Në Lekë	Viti 2012 Në Lekë
Shpenzimet nga interesi	(53,949,998)	(97,594,742)
Fitim ose humbje nga kursi i kembimit	(3,742,006)	(1,739,687)
TOTALI	(57,692,004)	(99,334,429)

12.8 Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat (Vazhdim)

Shpenzime per interesa paraqesin shumën e interesave të paguara për huatë e marra nga bankat e ndryshme Ato janë llogaritur në bazë të pagesave të kryera sipas schedulit të huase,. Fitimi nga interesat paraqet interesat bankare te llogaritura nga bankat për gjendjen e mjetve monetare pranë tyre.

Humbjet nga kursi i kembimit paraqesin humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në valutë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve, debitore e kreditore ne valute dhe huave bankare.

13. Tatimi aktual mbi fitimin

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël 32,896,244 leke. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2013 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qellime fiskale një sërë shpenzimesh.

Shoqëria ka zbatuar kërkesat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" për njohje dhe mosnjohje të shpenzimeve për efektin e llogaritjes së fitimit të tatueshëm.

Llogaritja e shpenzimeve të panjohura, dhe të ardhura të patatueshme të rezultatit fiskal për vitin 2013 paraqiten si në tabelën vijuese:

13. Tatimi aktual mbi fitimin - Vazhdim

Fitimi kontabel i vitit 2013	32,896,244
Te ardhura të pa tatueshme fiskalisht	0
Shpenzime të pazbritshme	(23,032,262)
Vlera e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit	(275,927)
Shpenzime amortizimi mbi kufirin ligjor	(18,318,397)
Shpenzime me fatura jo të rregullta tatimore	(150,467)
Gjoha dhe kamata vonesa	(1,025,258)
Shperblimi i punonjësve në natyrë	(770,082)
Interesa për hua të dhena të tregtimit	(2,492,131)
Fitimi tatimor për vitin 2013	55,928,506
<i>Tatim fitimi i vitit 2013 10%</i>	5,592,851
Fitimi neto kontabel	27,303,393

14. Transaksionet me palët e lidhura

Sipas statutit të shoqërisë, organi më i lartë vendimmarrës është asambleja e ortakëve. Shoqëria drejtohet nga administratori i saj dhe nga drejtori ekzekutiv.

15. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

TIRANA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT
TIRANA ALBANIA